



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1222 / Prot  
2

Tiranë, më 05. 7 .2022

VENDIM

Nr. 20 , datë 05. 7 .2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1222 Prot., datë 22.06.2022, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e gazetares pranë MCN TV, nëpërmjet kërkesës datë 27.05.2022, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me:

1. *Njoftimin mbi vlerësimin e detyrimeve tatimore* nr. 4916/10 Prot., datë 16.11.2006 të Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj.
2. *Vendimin nr. 12292/1 Prot.*, datë 15.01.2007.
3. *Raportin përfundimtar të Kontrollit nr. 9801/11 Prot.*, datë 23.09.2013 të Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj.
4. *Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 9801/12 datë 23.09.2013 të DRTTM.*

Autoriteti Publik nëpërmjet e-mail-it datë 09.06.2022, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “...*Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përcakton qartë institucionet ku Administrata Tatimore është e detyruar të japë informacion, konkretisht, neni 24 “Informacioni tatimor për tatimpaguesin, i administruar nga Administrata Tatimore, u ofrohet pa pagesë*”

autoriteteve të përcaktuara në këtë nen, pas depozitimit të kërkesës me shkrim dhe kur verifikohen rrethanat si: a) gjyqtarit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje civile, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore; b) gjyqtarit apo prokurorit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje penale, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore; c) Kontrollit të Lartë të Shtetit, vetëm për rastet, kur kërkesa e bërë është në funksion të kontrollit të kryer nga ky institucion ndaj administratës tatimore, në funksion të hartimit të rekomandimeve të veta; ç) autoritetit të ngjashëm të huaj, me të cilin Kuvendi ka ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare dhe informacioni kërkohet në kuadër të ekzekutimit të marrëveshjes; d) autoritetit homolog të huaj ose autoriteteve vendase, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe, me objekt shkëmbimin e informacionit; **DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE – LEGJISLACIONI TATIMOR 2016 Ligj Nr. 9920, datë 19.5.2008**; dh) institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj; e) çdo autoriteti tjetër, sipas parashikimit të bërë me ligj të veçantë.

Ndodhur në këto kushte, ankuesja i është drejtuar Zyrës së Komisionerit duke kërkuar ushtrimin e kompetencave, që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të cituar në kërkesën për informacion.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, me shkresën nr. 1222/1 Prot., datë 24.06.2022 ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesja, si dhe rivlerësimin e dhënies së dokumentacionit të kërkuar, brenda datës 01.07.2022.

Në vijim, Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it [zyraeshtypit@tatime.gov.al](mailto:zyraeshtypit@tatime.gov.al), datë 01.07.2022, ka kthyer përgjigje duke rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur në emailin e datës 09.06.2022 dërguar ankueses.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Refuzimi i dhënies së informacionit mbi bazën e nenit 24 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është i

gabuar, pasi, sipas qëndrimit të mbajtur nga Autoriteti Publik, aksesit në informacionin e disponuar nga autoritetet tatimore i'u legjitimohet vetëm institucioneve të përmendura në të, duke përjashtuar *a priori* çdo individ që kërkon akses sipas dispozitave të LDI.

Dispozita në fjalë parashikon autoritetet, të cilëve i'u ofrohet pa pagesë informacioni tatimor në lidhje me një tatimpagues të caktuar, por nuk parashikon ndalimin e dhënies së informacionit tatimor për subjekte të tjera mbi bazën e LDI.

Qëllimi i nenit 24 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk është përjashtimi i subjekteve të përmendura në të nga aksesit në informacionin e administruar nga administrata tatimore, por thjeshtimi i marrëdhënieve dhe komunikimit midis administratës tatimore me këto institucione, eficaenca dhe deburokratizimi i administratës publike.

Gjithashtu, parashikimet e nenit 24 janë të zbatueshme dhe për ato raste kur informacioni nuk përbën informacion publik në kuptim të LDI dhe dhënia e tij kryhet në një kontekst të caktuar siç është rasti i një procesi gjyqësor civil apo penal, kontrolli i ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në kuadër të veprimtarisë së tij, etj.

Ndërkohë, LDI rregullon dhënien e aksesit në informacionin publik për çdo person të interesuar. Ky ligj, në nenin 17 të tij gjithashtu përcakton dhe rastet kur dhënia e informacionit jepet në mënyrë të kufizuar. Në këto raste, Autoriteti Publik duhet të tregojë qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që refuzohen, si dhe në bazë të cilës pikë të nenit 17 bëhet ky refuzim. Nga verifikimi i përgjigjes së Autoritetit Publik, nuk rezulton të jetë argumentuar refuzimi i kërkesës në përputhje me këtë nen.

Në nenin 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”*. Në kuptim të këtij parashikimi, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar duke mbajtur në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI, ku përcaktohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Gjithashtu, kërkuesja/ankuesja është gazetare, e cila synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik.

Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen “*Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë*”, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikqyrësit shoqërorë”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

Si përfundim, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Nga praktikat e administruara nga Komisioneri, konstatohet se qëndrimi i mësipërm është i përsëritur nga administrata tatimore edhe pse Zyra e Komisionerit ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme ndaj këtij Autoriteti Publik, vendimmarrje, të cilat kanë mbetur në fuqi edhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

### **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankesës së znj. \_\_\_\_\_, nr. 1222 Prot., datë 22.06.2022, ndaj Autoritetit Publik “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 27.05.2022, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për

- të drejtën e informimit”, konkretisht: (1. Njoftimin mbi vlerësimin e detyrimeve tatimore" nr. 4916/10 Prot., datë 16.11.2006 të Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj. 2. Vendimin nr. 12292/1 Prot., datë 15.01.2007. 3. Raportin përfundimtar të Kontrollit nr. 9801/11 Prot., datë. 23.09.2013 të Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj. 4. Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 9801/12 datë. 23.09.2013 të DRTTM), brenda datës 12 . 7 .2022.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 05 . 7 .2022.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

3

